UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 176, datë 15.9.2022

MBI PROCEDURËN E SHPALLJES SË TË HUAJIT PERSON I PADËSHIRUAR DHE MIRATIMIN E MODELIT TË URDHRIT PËR SHPALLJEN E NJË TË HUAJI PERSON I PADËSHIRUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 104, pika 4, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me qëllim rregullimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për shpalljen e të huajit "person të padëshiruar" në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJMË:

1. Autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve të përcaktuara në nenin 4, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", sipas fushës së tyre të përgjegjësive ligjore dhe përcaktimeve në nenin 104, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", i propozojnë ministrit të Brendshëm shpalljen e të huajit si "person i padëshiruar", duke argumentuar arsyen e kërkesës/propozimit.
2. Strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, sipas fushës së tyre të përgjegjësive ligjore, kanë të drejtën të propozojnë shpalljen e të huajit si "person i padëshiruar", duke argumentuar arsyen e propozimit/kërkesës.
3. Ministri i Brendshëm, bazuar në propozimin/kërkesën e autoriteteve përgjegjëse të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, nxjerr urdhrin e shpalljes së të huajit si person i padëshiruar, sipas formatit të përcaktuar në aneksin nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi dhe njofton zyrtarisht Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ministri i Brendshëm, në rast të refuzimit të propozimit të një të huaji si person i padëshiruar argumenton refuzimin, si dhe informon institucionin propozues.
4. Pasi njoftohet zyrtarisht nga ministri i Brendshëm për urdhrin e shpalljes "person i padëshiruar", drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, nëpërmjet autoritetit shtetëror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, përgatit urdhrin e dëbimit për të huajin "person i padëshiruar" dhe e dërgon për nënshkrim pranë ministrit të Brendshëm.
5. Ministri i Brendshëm, pas nxjerrjes së urdhrit të dëbimit, njofton zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila nëpërmjet autoritetit shtetëror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, e përcjell atë për ekzekutim pranë autoritetit shtetëror përgjegjës në nivel vendor për kufirin dhe migracionin.
6. Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel vendor për kufirin dhe migracionin, pasi njoftohet zyrtarisht për urdhrin e dëbimit të nxjerrë nga ministri i Brendshëm, njofton të huajin dhe ekzekuton urdhrin e dëbimit, bazuar në kërkesat e nenit 106, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt".
7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka

DREJTOR I DEPARTAMENTIT ORGANIZATIV DHE BASHKËPUNIMIT NË DREJTORINË E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT
Rafail Milo

ANEKSI NR. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

"Sekret"
Afati i klasifikimit __ vjet
Kopje __
Nr. ____ prot. Tiranë, më___. ___.____

URDHËR

Nr. _____ , datë ___.___._____

PËR SHPALLJE "PERSON TË PADËSHIRUAR"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1, të nenit 104, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", dhe të udhëzimit nr. ___, datë __.__.20__, të Ministrit të Brendshëm, "Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë",

Bazuar në propozimin/kërkesën e autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve,

URDHËROJ:

1. Shpalljen "person të padëshiruar" në Republikën e Shqipërisë, për një periudhë __ -vjeçare, për _____ të shtetasit:

Mbiemri	Emri
Emri i babait	Emri i nënës
Datëlindja	Vendlindja
Gjinia	
Shtetësia	Nr. i dokumentit

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI